



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7203/7 Prot.

Tiranë, më 11.02 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 14, datë 11/02 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Colombo" shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, në procedurën e prokurimit: "Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)" me objekt: "*Rindërtim i objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak*", me fond limit 190.601.138 (njëqind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëmijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa Tvsh, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Shijak (në vijim "AK"), në datë 27.09.2021.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Colombo" Shpk, me NIPT J82916489E, me adresë: Lagja "Kryengritja e Fierit", Rruga "Vangjel Rrushku", Godina 67, Fier.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Colombo" shpk, ka nisur bazuar në kërkesën e AK, me të cilën është kërkuar përjashtimi i operatorit ekonomik "Colombo" nga e drejta për të fituar kontrata publike.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 14, datë 11. 02.2022, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Colombo" Shpk, me NIPT J82916489E, për 10 (dhjetë) muaj nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.